



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA**



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 37 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-23-7179-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-104-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-17517, për shkak të mos-përmbyshjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktorit: N.T.Sh. "Marash – Shped" ; SH.P.K COMPANY "BEJTA COMERCE" SH.A rr. Sadik Stavileci K. Gjakovë, me nr.unik 810238768 & 810274150, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 07.08.2025, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

**NJOFTIM
Për ndërprerjen e Kontratës**

Neni 37 i KPK përcakton se "Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës".
Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

a. Kontraktuesi ndërpre në punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;

b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;

c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;

d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;

e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

f. Kontraktuesi vonohet në përmbyshjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 01.09.2023, me numër të prokurimit: 632-23-7179-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-104-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-17517, me titull 'Rivitalizimi i Eshtnores-faza II, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe Punë kryesit N.T.Sh. " Marash – Shped" ; SH.P.K COMPANY " BEJTA COMERCE" SH.A rr. Sadik Stavileci K. Gjakovë, , do te ndërpritet me date,08.08.2025.

Kontrata do te ndërpritet duke u bazuar ne nenin 37, paragrafët, a dhe f te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Për mos realizimin e punëve konformë kushteve të kontratës jeni të informuar disa here radhazi përmes e-maileve, per vazhdimin e punimeve sipas datave: 29.03.2024, 27.05.2024,14.03.2025 dhe 21.03.2025, të dërguara nga Menaxheri i Kontratës, ku gjithashtu jeni paralajmëruar se nëse nuk filloni kryerjen e punëve do të vazhdohet me ndërprerje të kontratës dhe do të ndërmerren hapat tjerë ligjor (komunikimet i bashkëngjiten këtij njoftimi).

Përkundër vërejtjeve të shumta ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim të dinamikës për punimeve, duke u treguar i pa përgjegjshëm për detyrimet që ju ngarkon kontrata e sipërpërmendur Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar aktivitetin e prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 08.08.2025, do ti ndërmarrim të gjitha veprimet konforme kushteve te kontratës

Shkresës i bashkëngjiten te gjitha komunikimet e deritanishme dhe dëshmitë e mos realizimit te kontratës.

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS



OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

DATE:	04.08.2025
PËR/ZA/TO:	Komuna e Gjakovës Zyrës së Prokurimit - z. Faton Gutaj
KOPJE:	Organi Mbikëqyrës " AI Engineering" , Prishtinë - Valdrin Zenuni Grupi i OE – N.T.Sh. " Marash – Shped" ; SH.P.K COMPANY " BEJTA COMERCE" SH.A rr. Sadik Stavileci K. Gjakovë
PËRMES/PREKO/THROUGH	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport- . Fisnik Caka – Mbikqyrsi i Drejtperderjet i Ekipit per Menaxhimin e Kontrates
NGA/OD/FROM	FAZA II : z. Rexhë Rexha - Projekt Menaxheri dhe Valdrin Zenuni
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndërprerjen e kontratës për projektin "Rivitalizimi i EshnORES" – Faza e II , Qabrat Faza II: - Nr. prokurimit: 632-23-7179-5-2-1; Nr. kontratës: 632-23-7179-5-2-1/C784 Vlera (me TVSH): 69,800.00 € e lidhur me 01.09.2023

Të nderuar,

Në cilësinë e menaxherit te kontratës për Fazën II, ju drejtohem me këtë kërkesë zyrtare për ndërprerjen e kontratës e projektit " Rivitalizimi i EshnORES ", për arsye si më poshtë

Në cilësinë e menaxhimit te fazes së dytë të punimeve për perfundimine punimeve të EshnORES në Qabrat, , shkak të mos kryrejes se punimeve për fazën e parë, me të cilën kjo kontratë është në lidhshmëri të drejtpërdrejtë me fazën II, si menaxher, dhe Organin Mbikqyres z.Valdrin Zenuni e kemi bërë premjen e fazës së Dytë, ku kemi te njeteat veshtersi që e bëjnë të pamundur vazhdimin e projektit me standardet ligjore dhe profesionale.

Përmes shqyrtimit të gjendjes aktuale në terren dhe dokumentacionit të dorëzuar, është vërejtur se:

Punimet e fazës së dytë janë të ndërlidhura funksionalisht dhe teknikisht me fazën e parë, dhe mungesa e moskryerjen e punimeve për fazën e parë e bën të pamundur realizimin e fazës së dytë;

Kjo situatë **rrezikon zbatueshmërinë, cilësinë dhe transparencën e projektit**, si dhe cenon parimet e menaxhimit profesional të kontratës.

Grupit të OE ju ka përcjellur Urdherresat për vazhdimin e punimeve sipas datave:

1. 29.03.2024
2. 27.05.2024
3. 14.03.2025
4. 21.03.2025

Në këto kushte, **rekomandojmë ndërprerjen e menjëhershme të kontratës për fazën e dytë**. Kjo ndërprerje do të shmangte çdo dëm të mundshëm buxhetor apo teknik në të ardhmen.

Për këto arsye, propozojmë **ndërprerjen e kontratës**, sipas dispozitave ligjore në fuqi, me qëllim të mbrojtjes së interesit publik dhe profesionalizmit institucional.

Ju lutem që pas pranimit të kësaj kërkesë, të ndërmerren hapat e nevojshëm administrativë për procedurën e ndërprerjes së kontratës.

Kësaj shkrese ja bashkangjesim edhe komplet dokumentacionin e fazës së dytë si dhe fotot.

Faleminderit për mirëkuptimin.


Me respekt,

EKIPI PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS

1. Rexhë Rexha

2. Valdrin Zenuni







Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Gjakovë
Opština Gjakovica
Municipal of Gjakova

Autoriteti Kontraktues: K. Komunës ;
Zyra e Prokurimit

Adresa: rr. UÇK, p. n. Gjakovë

Datë: 29.03.2024

Operatoreve Ekonomik" - te paraqitur sipas
tabelarit te poshtë shënuar

Duke u bazuar në Nenin 70, paragrafin 13 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik,
Autoriteti Kontraktues (AK) lëshon këtë:

URDHERESË PËR VAZHDIMIN E PUNËVE

Nr.	Nr. Ide	TITULLI I KONTRATAVE	Operatori Ekonomik
Drejtoria e Infrastruktures			
1	022	Ndërtimi - Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobrigje	"Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k.
2	062	Ndërtimi - asfaltimi i rrugës në fshatin Doblibare	"Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k.
3	023	Ndërtimi - Asfaltimi i rr. ne fshatin Gërgoc	"Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k.
4	015	Ndërtimi-rrugës Shqiponjë-Kralan (rruga Shaban Zeka) -Kontratë tri vjeçare	"Joos&Krasniqi-Bazë" & "Enex Trade"
5	003	Ndërtimi Qarkores, vazhdimi i rrugës "Bujar Roka"	SH. "Drini Company" sh.p.k.
6	096	Zgjerimi i rrugës Nëna Terezë – Kontratë tri vjeçare	"Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k.
7	043	Ndërtimi – asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës - Kontratë dy vjeçare - Pjesa e katërt, Lot IV-të: Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Ponoshec, Popoc dhe Shishman	"Art konstruksion" sh.p.k.
8	063	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës - Kontratë dy	n.n.t. "Burimi"

		vjeçare, Pjesa e Tretë, Lot IV: Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Smolicë, Stubell, Bërhah dhe Nivokaz	
9	003	Ndërtimi – asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës, pjesa -I-rë, Ndërtimi – segmenteve rrugore nga fsh. Ramoc - Dobrosh	SH. "Drini Company" sh.p.k.
10	002	Ri-Shpallje Ndërtimi Qarkores – Tranziti i ri	SH. "Drini Company" sh.p.k.
11	003	Ndërtimi – asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës – Pjesa e I-rë, Lot II-të: Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Muhader, Prish, Demjan	"Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k.
12	063	Ndërtimi - Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës – Kontratë dy vjeçare, Pjesa e tretë, Lot V -Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Piskotë-faza e II-të	n.n.sh. "Korben"
13	077	Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve te Pika e Zezë, Pjesa II-të	n.n.sh. "Korben"
14	076	Ndërtimi i Urës për Këmbësor dhe Bicikleta mbi Lumin Erenik	n.n.sh. "Korben"
15	128	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike në rrugë Lekë Dukagjini-Dardani- Gjakovë	CNT "Mulaj" sh.p.k.
16	005	Ndërtimi – asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës, Pjesa V-të: Ndërtimi – asfaltimi i rrugëve në fshatrat Devë - Guskë	"Berisha Com" sh.p.k.
17	063	Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë - Pjesë e Qarkores së Qytetit	"Berisha Com" sh.p.k.
18	014	Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Kodra e Sukës - Cërmjan	"REA" sh.p.k.
19	059	Zgjerimi i rrugës Martirët e Kombit - Hyrja Përendimore e Qytetit	"ARFA GROUP"
21	030	Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë - Pjesë e Qarkores së Qytetit, segmenti i dytë, faza e dytë	"Berisha Com" sh.p.k.
22	077	Ndërtimi i terreneve të tenisit	"BK - Construction" sh.p.k.
23	072	Rregullimi i rrugës dhe parkingjeve te ambulanta e vjetër	"Capital X Fet" sh.p.k.
24	067	Ndërtimi - asfaltimi i rrugës në fshatin Bitesh	"Mirusha Company" sh.p.k.
25	055	Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Qerim, Lugbunar	"REA" sh.p.k.
26	023	Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut	"REA" sh.p.k.
27	056	Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve Petro Nini Luarasi	"REA" sh.p.k.
28	632-23-7263-5-2-1/C782	Ndërtimi-Asfaltimi i Rrugëve në fshatrat, Korenicë, Orize, Meje, Jahoc, Nec – nr.ident.	"SH. Drini Company SH.P.K.
29	632-23-6757-5-2-1/C783	NDERTIMI - ASFALTIMI I RRUGES NE FSHATIN ROGOVË	"SH. Drini Company SH.P.K.
30	632-23-10630-5-2-1/C839	Ri Tender-Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Babaj Bokës, Shishman, Duzhnje	Grup i Operatorëve Ekonomik BERISHA COM SH.P.K.; VIZION PLUS SH.P.K.

31	632-23-7269-5-2-1/C789	NDERTIMI - ASFALTIMI I RRUGES NE FSHATIN Lipovec, Gërginë	"SH. Drini Company SH.P.K.
32	632-23-6756-5-2-1/C774	Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatrat Jabllanicë, Gërgoc, Zhabel, Bardhaniq,	"N.N.T. " Shkodrani "
33	632-23-6334-5-2-1/C830	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Doblibare, Berdosanë, Vraniq dhe Rezinë	"N.N.T. " Shkodrani "
34	632-23-5431-5-2-1/C795	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Devë, Guskë	Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I.
35	632-23-6839-5-2-1/C791	Ndërtimi - Asfaltimi i Rrugëve në fshatrat Molliq, Nivokaz, Brovinë	Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; Bujar Shabani B.I.
Drejtoria e Bujqësisë - 2023			
Nr.	Nr. Ide	Emri i Projektit (Kontratës)	Operatori Ekonomik
36	137	Sanimi i pendave dhe kanaleve të ujërës në zona rurale - Kontrate dy vjeçare	"REA" sh.p.k.
Drejtoria e Kulturës - 2023			
Nr.	Nr. Ide	Emri i Projektit (Kontratës)	Operatori Ekonomik
37	043	Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Rogovë të Hasit, Në Komunën e Gjakovës	n.n.sh. "Korben"
38	104	Rivitalizimi i Eshtnores - faza II	"Marash Shped" sh.p.k.

Përmes kësaj URDHERESE të Vazhdimit të Punëve, Menaxheri i Kontratave të lartshënuara i urdhëron Operatorët Ekonomik: që më datë 04.04. 2024 të fillojë me zbatimin e punëve sipas Kontratave (Kushteve të Veçanta – KVK dhe Kushteve të Përgjithshme të Kontratës – KPK), dokumentacionit investivo-teknik, dhe tërë shkresave dhe urdhërësive të lëshuara apo që do të lëshohen nga Autoriteti Kontraktues. Operatorët Ekonomik obligohen që të gjitha punët e specifikuar sipas kësaj kontrate, KVK dhe KPK si dhe urdhërësive dhe shkresave që do të lëshohen nga Autoriteti Kontraktues, duhet ti përfundoni brenda afatit të caktuar sipas kontratës.

Menaxheri i Kontratës: **Rexhë Rexha**

Nënshkrimi:

Datë: 29.03.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	27.05.2024
PËR/ZA/TO:	Grupi i Operatorve Ekonomik N. T. Sh. " Marash – Shped" sh.p.k.; Company " Bejta Commerce" SH.A. rr. Sadik Stravileci, Gjakovë
CC:	• Zyrën e Prokurimit – z. Faton Gutaj • Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – znj. Adea Roka • Organin Mbikëqyrës " AL - Engineering", Prishtinë - z. Valdrin Zenuni • Kryetari i Komunës, z. Ardian Gjini
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM	Projekt Menaxheri – z. Rexhë Rexha
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vërejtje për mos respektimin e Urdhëresës për vazhdimin e punimeve të kontrata: Ri - vitalizimi i Eshtnores- faza-II me nr. te prokurimit 632-23-7179-5-2-1

Te nderuar

Edhe pas Urdhëresës të muajit mars për vazhdimin e punimeve ju nuk keni vazhduar punimet pa kurfat paralajmerimi – as te Organi Mbikqyrës e as zyra e Menaxherit. Sot me datën 27.05.2023 është Vërejtja e parafundit për mos përfillje të Urdhëresës.

Unë Kërkoj urgjentisht që Grupi i Operatorve Ekonomik N. T. Sh. " Marash – Shped" sh.p.k.; Company " Bejta Commerce" SH.A. rr. Sadik Stravileci, Gjakovë të paraqiteni te Njësia Kërkuese, Projekt Menaxheri, Organi Mbikqyrës dhe Zyra e Prokurimit të na njoftoni nëse keni arsye për vazhdimin apo mos vazhdimin e punimeve dhe mosrespektimin e Urdhëresës në të kundërtën do të merren masa disiplinore ndaj jush, **sepse nuk keni asnjë bazë ligjore për mos vazhdim të punimeve. Afati për paraqitje deri në fundin e javës dt. 31.05.2024.**



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



GJAKOVA
Komuna Gjakovë
Qoshina Diakovica
Municipal of Gjakova

Për: Grupin e operatorëve ekonomik: N.T.Sh. " Marash – Shped" sh.p.k. COMPANY " BEJTA
COMMERCE" SH.A. rr. Sadik Stavileci Gjakovë me nr.unik 810238768 & 810274150
Nga: Menaxheri i Kontratës Rexhë Rexha
CC: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;

Organi Mbikqyres – Valdrin Zenuni dhe

Zyra e Prokurimit – z. Faton Gutaj

Lënda: Njoftim paralajmërues për vonesë të paarsyeshme në ekzekutimin e punëve
Data: 14.03.2025

Titulli i Kontratës: Rivalizimi i Eshtnores – Faza e II
Numri i Prokurimit: 632-23-7179-5-2-1

Të nderuar : Grupin e operatorëve ekonomik: N.T.Sh. " Marash – Shped" sh.p.k. COMPANY " BEJTA
COMMERCE" SH.A. rr. Sadik Stavileci Gjakovë duke u bazuar në Kushtet e Kontratës, Planin e
Menaxhimit të Kontratës C01, Planin Dinamik të ekzekutimit të punëve, si dhe vizitat në vend-
punishte, janë konstatuar vonesa në ekzekutimin e punëve.

Me qëllim të ri-vendosjes së procesit të ekzekutimit të punëve dhe sigurimit që të gjitha obligimet
sipas kontratës të përfundohen, kërkojmë nga Grupi i Operatorëve Ekonomik që të ndërmerren
masa të menjëhershme që deri me datën 18.03.2025 të vazhdojnë punimet e ngelura si dhe të
kryhen menjëherë.

Nëse dështoni në përmbushjen e aktiviteteve të punimeve - përfundimin e kontratës , atëherë do të
aplikohen masat disiplinore sipas Ligjit i Prokurimit.

Shpresojmë në korrektësi nga ana e juaj!

Menaxheri i Kontratës: Rexhë Rexha

Nënshkrimi:



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



GJAKOVA
Komuna Gjakovë
Opština Gjakovica
Municipal of Gjakova

Për: Grupin e operatorëve ekonomik: N.T.Sh. " Marash – Shped" sh.p.k. COMPANY " BEJTA
COMMERCE" SH.A. rr. Sadik Stavileci Gjakovë me nr.unik 810238768 & 810274150
Nga: Menaxheri i Kontratës Rexhë Rexha
CC: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;

Organi Mbiqyres – Valdrin Zenuni dhe

Zyra e Prokurimit – z. Faton Gutaj
Lënda: Njoftim paralajmërues për vonesë të paarsyeshme në ekzekutimin e punëve
Data: 21.03.2025

Titulli i Kontratës: Rivitalizimi i Eshtnores – Faza e II
Numri i Prokurimit: 632-23-7179-5-2-1

Të nderuar : Grupin e operatorëve ekonomik: N.T.Sh. " Marash – Shped" sh.p.k. COMPANY " BEJTA
COMMERCE" SH.A. rr. Sadik Stavileci Gjakovë duke u bazuar në Kushtet e Kontratës, Planin e
Menaxhimit të Kontratës C01, Planin Dinamik të ekzekutimit të punëve, si dhe vizitat në vend-
punishte, janë konstatuar vonesa në ekzekutimin e punëve.

Me qëllim të ri-vendosjes së procesit të ekzekutimit të punëve dhe sigurimit që të gjitha obligimet
sipas kontratës të përfundohen, kërkojmë nga Grupi i Operatorëve Ekonomik që të ndërmerren
masa ne afatin prej 5 ditësh nga dita e sotit me datën 26.03.2025 te vazhdohen punimet e ngelura
si dhe te kryhen menjëherë.

Nëse nuk paraqiteni te Oranani mbiqyres dhe Menaxheri me datën e lartcekur , atëherë do të
aplikohen masat disiplinore sipas Ligjit i Prokurimit – Porpozim per shkëputje te kontraes

Shpresojmë në korrektësi nga ana e juaj!

Menaxheri i Kontratës: Rexhë Rexha

Nënshkrimi: